

## KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot më 10/02/2022 ortaku i shoqërisë "BLUE - PHARMA" sh.p.k. me NIPT L82008020I dhe me adresë Qendra Tregtare "Casa Italia", Kati I, Tirane, **Znj. Arjola Çausholli**, lindur në Kamëz me 14.05.1986 me Nr. Personal I65514098G dhe **Znj. Gerta Doçi**, lindur në Tiranë më 30/09/1983 me Nr. Identifikimi 036840617 dhe Nr. personal I35930054M. Të dy palët si dhuruesi dhe pranuesi janë dakord me dhurimin e kuotave.

**Palët janë:**

**Dhuruesi: Znj. Arjola Çausholli**, lindur në Kamëz me 14.05.1986 me Nr. Personal I65514098G.

**Pranuesi: Znj. Gerta Doçi**, lindur në Tiranë më 30/09/1983 me Nr. Identifikimi 036840617 dhe Nr. personal I35930054M.

### Neni 1: Objekti kontratës

Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i pjesëmarrjes në përqindje 100% të **Znj. Arjola Çausholli** që zotëron tek shoqëria "BLUE - PHARMA" sh.p.k. për tek **Znj. Gerta Doçi**.

### Neni 2: Vlera e dhurimit

Palët bien dakord që vlera e dhurimit të 100% të pjesëmarrjes në përqindje që **Znj. Arjola Çausholli** ka tek shoqëria "BLUE - PHARMA" sh.p.k. është ajo e pasqyruar ne Ekstrakt. Këto kuota do i dhurohen **Znj. Gerta Doçi**. Palët nuk kanë asnjë pretendim kundrejt njëri-tjetrit, përsa i përket këtij neni.

### Neni 3: Kalimi i pronësisë

Hyrja në fuqi e kontratës do te realizohet kur nënshkruhet nga palët. Ekzekutimi i veprimeve për kalimin e plotë të pronësisë do të realizohet pranë Q.K.B.

### Neni 4: Të drejtat dhe detyrimet e Dhuruesit

**Dhuruesi** merr përsipër, garanton dhe siguron pranuesin se deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe të nënshkrimit të Kontratës, kuotat e mësipërme janë:

1. Të lira nga cdo lloj barre dhe pengu;
2. Nuk jane objekt i ndonje konflikti gjyqësor
3. Nuk ka persona të tretë që të kenë pretendime në lidhje me pronësinë mbi këto kuota.

**Pranuesi** është i detyruar të paguaje tatimin mbi të ardhurat nga dhurimi, në qoftë se do të ketë, në përputhje me legjislacionin tatimor në fuqi.

### Neni 5: Të drejtat dhe detyrimet e Pranuesit

Ai ka të drejtë të gëzojë i qetë kuotat nga **Dhuruesi** dhe në rast të kundërt, të kërkojë nga ky i fundit të zgjidhë konfliktin që mund të vijë nga të tretët, për probleme të lindura përpara datës së dhurimit së kuotave.

### Neni 6: Interpretimi i kontratës në tërësi


Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e terësisë së kontratës dhe në këndvështrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë kontratë.

### Neni 7: Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

Të gjitha mosmarreveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj kontrate, janë objekt shqyrtimi para Gjyqates së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**DHURUESI**

**Arjola Çausholli**

  
10/02/2022

**PRANUESI**

**Gerta Doçi**

